




Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 3: Statistikat Ekonomike**

# **Statistikat Afatshkurtra të Tregtisë me Pakicë (TM2 – 2015)**



## **P a r a t h ë n i e**

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur publikimin e rezultateve të Statistikave tremujore të *tregtisë me pakicë* për periudhën TM2 2015 (2013=100).

Nga tremujori i parë i 2013, e këndej ky hulumtim është pjesë përbërëse e Programit statistikor të ASK - së dhe bazohet në deklaratimet e ndërmarrjeve. Ky hulumtim do të publikohet në baza të rregullta tremujore.

Rezultatet e këtij hulumtimi paraqesin ecurinë në tregtinë me pakicë në periudha tremujore.

Gjithashtu këto rezultate përdoren për nevoja përpilimit të llogarive kombëtare dhe janë burim i rëndësishëm në përpilimin e Bruto Produktit Vendor me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve në baza tremujore.

Publikimin e pergaditën:

Ilir T. Berisha - Drejtor i departamentit  
Ismail Sahiti - Shef i divizionit,  
Hysni Elshani - Shef i sektorit,  
Bekim Bojku - Zyrtar,  
Muhamet Kastrati - Specialist i TI-së për RSB,  
Valdete Navakazi - Zyrtare,  
Luljeta Krasniqi – Zyrtare dhe  
Violeta Sylja - praktikante nga SIDA Suedeze.

(E-mail: **economic@rks-gov.net**)

Shtator, 2015

Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së,  
z. Isa Krasniqi

### Simbolet dhe shkurtesat

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
NVE	-	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike
ATK	-	Administrata Tatimore e Kosovës
ARBK	-	Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
RSB	-	Regjistri Statistikorë i Bizneseve
SAN	-	Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve

TM1	-	Tremujori i parë
TM2	-	Tremujori i dytë
TM3	-	Tremujori i tretë
TM4	-	Tremujori i katërt

### Simbolet

:	-	Mungojnë të dhënat
n/a	-	Nuk aplikohet

## Përmbajtja

	Faqe
1	Objektivi, metodologjia dhe shtrirja e anketës.....4
1.1.	Objektivi..... 4
1.2.	Metodologjia dhe shtrirja e anketës ..... 4
1.3.	Korniza për mostër dhe përzgjedhja e mostrës ..... 4
1.4.	Procedurat e mbledhjes (grumbullimit) të të dhënave ..... 5
2	Definicione, përkufizime dhe treguesit themelorë..... 6
2.1.	Definicione dhe përkufizime ..... 6
2.2.	Treguesit themelorë ..... 6
3	Tregtia me Pakicë ..... 7
3.1.	Struktura e qarkullimit në sektorin e tregtisë me pakicë ..... 7
4	Indeksi i qarkullimit dhe numrit të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë ..... 9
4.1.	Indeksi i qarkullimit në sektorin e tregtisë me pakicë ..... 9
4.1.	Indeksi i numrit të të punësuarve ..... 11

## **1 Objektivi, metodologjia dhe shtrirja e anketës**

### **1.1. Objektivi**

Objektivi kryesor i Anketës së Statistikave afatshkurtra të ndërmarrjeve tregtare është paraqitja e trendeve nëpër periudha tremujore në sektorin e tregtisë me pakicë, nëpërmjet disa treguesve ekonomik, që mundëson krahasueshmërinë e të dhënave në nivel ndërkombëtar duke pasur parasysh standardet Evropiane për statistikat tremujore. Anketa synon t'i plotësojë kërkesat për informacione më të plota statistikore në kushtet e ekonomisë së tregut dhe ofron të dhëna mbi aktivitetet ekonomike të ndërmarrjeve në sektorin e tregtisë me pakicë.

### **1.2. Metodologjia dhe shtrirja e anketës**

Statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike në sektorin e tregtisë me pakicë, publikojnë të dhënat për tremujorin e dytë 2015 sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike NVE Rev.2.

Anketa mbulon në mënyrë të përmbledhur sektorin e tregtisë me pakicë me përjashtim të tregtisë (shpërndarjen) e energjisë me pakicë.

Metodologjia e përdorur për përpilimin e instrumenteve për anketë, nomenklatura dhe përgatitja e të dhënave për publikim është sipas rregullave dhe rekomandimeve të EUROSTAT-it.

Pyetësi është përpiluar në bashkëpunim me Ekspert të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Anketa është kryer në tërë territorin e Kosovës dhe përfshinë sektorin e tregtisë me pakicë.

### **1.3. Korniza për mostër dhe përzgjedhja e mostrës**

Për krijimin (përcaktimin) e kornizës së mostrës janë shfrytëzuar të dhënat nga regjistri statistikor i bizneseve. Të gjitha ndërmarrjet që kanë deklaruar njërin nga tatimet gjatë vitit të fundit kalendarik si dhe periudhën paraprake janë konsideruar aktive. Përzgjedhja e mostrës është bërë në bazë të kriterit të mbulueshmërisë së niveleve 4-shifrore të aktiviteteve ekonomike, ku janë përfshirë të gjitha ndërmarrjet që përfaqësojnë 80% të qarkullimit për aktivitetin përkatës të NVE Rev2. Numri i ndërmarrjeve të përfshira në anketë është 586, në sektorin e tregtisë me pakicë.

#### **1.4. Procedurat e mbledhjes (grumbullimit) së të dhënave**

Gjatë fazës së grumbullimit së të dhënave nga terreni janë shfrytëzuar metodat standarde të marrjes së informacionit statistikor, sikurse janë metoda e intervistimit të drejtëpërdrejt të ndërmarrjeve nga anketuesit, metoda e dërgimit të pyetësorit në mënyrë elektronike si dhe metoda e lënies së pyetësorit për plotësim tek bizneset.

Anketa në teren del 20 ditë pas përfundimit të tremujorit dhe afati për grumbullimin e të dhënave nga terreni është 40 ditë pas daljes në terren.

## 2 Definicione, përkufizime dhe treguesit themelorë

### 2.1. Definicione dhe përkufizime

**Ndërmarrja** është njësi më e vogël e kombinimit të njësisë legale me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendim - marrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrojë një ose disa aktivitete ekonomike.

**Ndërmarrje aktive** - konsiderohen vetëm ato ndërmarrje që kanë deklaruar njërin nga tatimet apo ndonjë të punësuar për vitin e fundit kalendarik si dhe periudhën referuese.

**Vlera e qarkullimit nga prodhimi** - paraqet qarkullimin e realizuar nga prodhimi duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar.

**Indekset** - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres.

$$P_L = \frac{\sum(p_{c,t_n} \cdot q_{c,t_0})}{\sum(p_{c,t_0} \cdot q_{c,t_0})}$$

**Indeksi i vlerës së qarkullimit nga tregtia me pakicë** - paraqet ndryshimin e qarkullimit të realizuar nga tregtia me pakicë në një tremujor krahasuar me mesataren tremujore të vitit bazë (2013).

**Numri i të punësuarve** - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë që punojnë në ndërmarrje (përjashtuar pjesëtarët e familjes që punojnë pa pagesë).

**Indeksi i Numrit të punësuarve** - Indeksi i punësimit paraqet ecurinë e punësimit në ndërmarrjet e anketuara.

### 2.2. Treguesit themelorë

**Treguesit** - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vitin referues bazë, aktualisht 2013 = 100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

**Ndryshimi tremujor në përqindje** - Shprehë ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

**Rishikimi** - Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlerësime të koeficienteve të përdorur etj.

### 3 Tregtia me Pakicë

#### 3.1. Struktura e qarkullimit në sektorin e tregtisë me pakicë

##### Tremujori i dytë 2015 / Tremujori i parë 2015

Në tremujorin e dytë të vitit 2015 krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2015, rritje kanë: *Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara 36.8%, Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara 30.8%, Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuara 21.3%, Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara 17.3%, Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje 3.8% Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara 2.8% dhe Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara 0.9%.*

Rënie ka pasur: *Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara 26%.*

##### Tremujori i dytë 2015 / Tremujori i dytë 2014

Në tremujorin e dytë të vitit 2015 krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2014, rritje kanë: *Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuar 34.0%, Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara 13.7%, Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje 2.3%, Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara 2.0% dhe Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara 1.9%.*

Rënie kanë pasur: *Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara 37.6%, Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara 8.5%, Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara 3.4%.*



### **3.2. Numri i të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë**

#### **Tremujori i dytë 2015 / Tremujori i parë 2015**

Në tremujorin e dytë të vitit 2015 krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2015, rritje të numrit të punëtoreve kanë: *Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezgja ose tregje 12.7%, Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara 11.5%, Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara 7.3%, Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara 6.7%, Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara 3.7% dhe Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara 1.9%.*

Rënie kanë pasur: *Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuar 22.9% dhe Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara 9.1%.*

#### **Tremujori i dytë 2015 / Tremujori i dytë 2014**

Në tremujorin e dytë të vitit 2015 krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit 2014, rritje të numrit të punëtorëve kanë :

*Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezgja ose tregje 20.0%, Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara 3.9%, Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara 3.7 % dhe Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara 0.5%*

Rënie kanë pasur: *Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuara 28.5% Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit në dyqane të specializuara dhe Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara 9.4% dhe Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit në dyqane të specializuara 5.8%.*


## 4 Indeksi i qarkullimit dhe numrit të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë

### 4.1. Indeksi i qarkullimit në sektorin e tregtisë me pakicë

Tab 1. Indeksi i qarkullimit në sektorin e tregtisë me pakicë (2013 = 100)

Nëngrupi (NACE Rev.2)	Aktiviteti ekonomik	2013 TM1	2013 TM2	2013 TM3	2013 TM4	2014 TM1	2014 TM2	2014 TM3	2014 TM4	2015 TM1	2015 TM2
471	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara	91,83	84,88	113,73	109,56	86,5	110,2	127,4	122,4	109,2	112,3
472	Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara	105,94	101,61	101,93	90,52	90,7	110,4	111,7	103,9	93,3	69,0
473	Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuar	83,89	91,89	120,48	103,75	76,4	85,8	105,9	100,7	94,8	114,9
474	Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara	82,55	94,24	109,29	113,92	90,5	127,4	116,0	111,5	95,0	129,9
475	Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara	75,56	98,31	120,80	105,32	85,66	131,16	124,95	138,4	102,3	120,0
476	Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara	111,71	83,17	108,21	96,90	70,09	110,51	116,41	91,8	81,6	106,7
477	Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara	101,44	84,60	104,35	109,61	92,54	92,48	92,02	91,4	104,1	105,1
479	Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje	91,81	109,29	93,50	105,40	99,4	82,7	71,7	89,1	81,4	84,5

Figura 1. Indeksi i qarkullimit në sektorin e tregtisë me pakicë (2013=100)



**Tab 1a. Ndryshimi i indeksit të qarkullimit të tregtisë me pakicë nëpër periudha tremujore me tremujorin paraprak**

Nëngrupi (NACE Rev.2)	Aktiviteti ekonomik	2014 TM1	2014 TM2	2014 TM3	2014 TM4	2015 TM1	2015 TM2
		2013 TM4	2014 TM1	2014 TM2	2014 TM3	2014 TM4	2015 TM1
471	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara	-21,0	27,4	15,5	-3,9	-10,7	2,8
472	Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara	0,2	21,8	1,1	-6,9	-10,2	-26,1
473	Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuar	-26,3	12,2	23,5	-4,8	-5,9	21,3
474	Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara	-20,5	40,7	-8,9	-3,9	-14,8	36,8
475	Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara	-18,7	53,1	-4,7	10,8	-26,1	17,3
476	Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara	-27,7	57,7	5,3	-21,2	-11,1	30,8
477	Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara	-15,6	-0,1	-0,5	-0,6	13,9	0,9
479	Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje	-5,7	-16,9	-13,2	24,2	-8,6	3,8

**Tab 1b. Ndryshimi i indeksit të qarkullimit të tregtisë me pakicë nëpër periudha tremujore me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak**


Nëngrupi (NACE Rev.2)	Aktiviteti ekonomik	2014 TM1	2014 TM2	2014 TM3	2014 TM4	2015 TM1	2015 TM2
		2013 TM1	2013 TM2	2013 TM3	2013 TM4	2014 TM1	2014 TM2
471	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara	-5,8	29,9	12,0	11,7	26,2	1,9
472	Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara	-14,4	8,7	9,6	14,8	2,9	-37,6
473	Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuar	-8,9	-6,7	-12,1	-2,9	24,0	34,0
474	Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara	9,7	35,2	6,2	-2,1	4,9	2,0
475	Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara	13,4	33,4	3,4	31,5	19,4	-8,5
476	Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara	-37,3	32,9	7,6	-5,3	16,4	-3,4
477	Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara	-8,8	9,3	-11,8	-16,6	12,5	13,7
479	Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje	8,3	-24,4	-23,3	-15,5	-18,1	2,3

#### 4.1. Indeksi i numrit të të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë

**Tab 2. Indeksi i numrit të të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë nëpër periudha tremujore**

Nëngrupi (NACE Rev.2)	Aktiviteti ekonomik	2013 TM1	2013 TM2	2013 TM3	2013 TM4	2014 TM1	2014 TM2	2014 TM3	2014 TM4	2015 TM1	2015 TM2
471	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara	105,73	83,69	112,87	97,71	100,37	122,21	125,17	125,62	120,49	122,81
472	Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara	94,56	103,34	99,93	102,16	108,32	102,03	105,89	105,11	95,09	106,00
473	Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuar	102,52	96,76	99,98	100,74	106,44	104,83	103,27	103,83	97,16	74,92
474	Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara	109,94	95,06	99,00	95,99	106,58	101,54	85,84	87,55	89,08	95,60
475	Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara	119,64	95,19	92,88	92,29	104,62	113,43	117,22	113,92	113,39	117,62
476	Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara	101,41	95,77	107,04	95,77	92,02	99,53	98,59	98,59	84,51	90,14
477	Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara	109,80	86,25	102,39	101,56	125,11	112,04	113,70	112,18	111,70	101,50
479	Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje	103,29	93,27	108,92	94,52	96,40	105,79	105,16	105,16	112,68	126,95

**Figura 2. Numri i të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë (2013=100)**



**Tab 2a. Ndryshimi i indeksit numrit të të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë nëpër periudha tremujore në raport me tremujorin paraprak**

Nëngrupi (NACE Rev.2)	Aktiviteti ekonomik	2014 TM1	2014 TM2	2014 TM3	2014 TM4	2015 TM1	2015 TM2
		2013 TM4	2014 TM1	2014 TM2	2014 TM3	2014 TM4	2015 TM1
471	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara	-20,8	34,9	-13,4	0,4	-4,1	1,9
472	Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara	9,3	-3,3	2,2	-0,7	-9,5	11,5
473	Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuar	-5,6	3,3	0,8	0,5	-6,4	-22,9
474	Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara	-13,5	4,1	-3,0	2,0	1,7	7,3
475	Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara	-20,4	-2,4	-0,6	-2,8	-0,5	3,7
476	Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara	-5,6	11,8	-10,5	0,0	-14,3	6,7
477	Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara	-21,5	18,7	-0,8	-1,3	-0,4	-9,1
479	Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje	-9,7	16,8	-13,2	0,0	7,1	12,7

**Tab 2b. Ndryshimi i indeksit të numrit të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë nëpër periudha në raport me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak**

Nëngrupi (NACE Rev.2)	Aktiviteti ekonomik	2014 TM1	2014 TM2	2014 TM3	2014 TM4	2015 TM1	2015 TM2
		2013 TM1	2013 TM2	2013 TM3	2013 TM4	2014 TM1	2014 TM2
471	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara	-5,1	46,0	10,9	28,6	20,0	0,5
472	Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara	14,5	-1,3	6,0	2,9	-12,2	3,9
473	Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuar	3,8	8,3	3,3	3,1	-8,7	-28,5
474	Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara	-3,1	6,8	-13,3	-8,8	-16,4	-5,8
475	Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara	-12,6	19,2	26,2	23,4	8,4	3,7
476	Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara	-9,3	3,9	-7,9	2,9	-8,2	-9,4
477	Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara	13,9	29,9	11,0	10,5	-10,7	-9,4
479	Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje	-6,7	13,4	-3,4	11,3	16,9	20,0

# Agjencia e statistikave të Kosovës

## *përshkrim i shkurtër*

**Agjencia e statistikave të Kosovës** është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

**Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: *Departamentet prodhuese;* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. **Departamentet mbështetëse;** (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Ne kuadër të Agjencionit vepron edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj**

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 139 punëtorë, prej tyre, 104 (74,8%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 35 (25,2%), Agjencioni ka ketë strukturë kualifikuese, 70,5% me shkollim universitar ndërsa 29,5% me shkollim te mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikatat e shteteve në rajon.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Kemi realizuar me sukses në vitin 2011 projektin e Regjistrimit të Popullsisë Ekonomive Familjar dhe banesave, i cili regjistrim nuk është realizuar që nga viti 1981. Rezultatet e fituara nga ky regjistrim do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

**Misioni i Agjencionit;** të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**  
Rr. "Zenele Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129  
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** [economic@rks-gov.net](mailto:economic@rks-gov.net)
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>